REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS

Durrës 14.10.2026

Lënda: Kthim përgjigje

Bazuar në ligjin 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", I ndryshuar, në përgjigje të kërkesës suaj ju informojmë si mëposhtë vijon:

Projekti Eco Park Durrës I cili lidhet me rehabilitimin e landfillit të Porto Romanos dhe ndërtimin e parkut ekologjik, nuk është investim i Bashkisë Durrës.

Në vijim të kërkesës për informacion mbi aktivitetet e zhvilluara në Eco Park Durrës për vitet 2023, 2024, 2025 dhe 2026, ju bëjmë me dije se Agjencia e Parqeve Urbane, Bashkia Durrës, ka marrë në administrim Eco Park-un gjatë vitit 2024. Për këtë arsye, informacioni i mëposhtëm i referohet aktiviteteve të zhvilluara nga viti 2024 e në vijim, deri më sot.

Gjatë kësaj periudhe, Eco Park ka shërbyer si një hapësirë e rëndësishme për zhvillimin e aktiviteteve sportive, edukative, rekreative dhe turistike, ndër të cilat:

* Zhvillimi i aktivitetit “Ballkan Cup – JADA”, aktivitet sportiv që zhvillohet çdo vit dhe që mbledh pjesëmarrës dhe sportdashës në ambiente të Eco Park-ut.
* Aktivitete të alpinizmit dhe climbing, të zhvilluara në kuadër të aktiviteteve sportive dhe rekreative.
* Aktivitete sportive dhe edukative të institucioneve arsimore, ku përfshihen shkolla të ndryshme të qytetit të Durrësit, si dhe aktivitete të organizuara nga Universiteti i Sporteve të Tiranës.
* Aktivitete për fëmijë nga kopshte të ndryshme, të cilat përdorin hapësirat e parkut për lojëra, aktivitete në grup, lëvizje fizike dhe argëtim.
* Zhvillimi i aktiviteteve rekreative në ambientet e parkut, duke e kthyer Eco Park-un në një hapësirë të frekuentuar për familje, fëmijë, të rinj dhe sportdashës.
* Përdorimi i fushave të tenisit, të cilat gjatë gjithë vitit frekuentohen jo vetëm nga qytetarë vendas, por edhe nga turistë të huaj, veçanërisht gjatë sezonit turistik.
* Zhvillimi i kampionateve dhe aktiviteteve të basketbollit, me pjesëmarrjen e ekipeve sportive të Durrësit dhe Tiranës.
* Zhvillimi i aktiviteteve dhe kampionateve të volejbollit, me pjesëmarrjen e ekipeve të ndryshme sportive.

* Aktivitete të ndryshme sportive në grup, stërvitje dhe ndeshje të organizuara nga klube, ekipe dhe institucione sportive.

Në tërësi, gjatë periudhës së administrimit nga Agjencia e Parqeve Urbane, Eco Park Durrës ka vijuar të funksionojë si një hapësirë multifunksionale, e cila i shërben komunitetit për aktivitete sportive, edukative, rekreative dhe turistike.